



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 31-25/2018 regjistër (JR)
Datë 29.03.2023

Nr. 59 i vendimit
Datë 24.03.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, ditën e martë, më datë 24.03.2026, në orën 11.02, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen që i përket:

KËRKUES: Bledar Abdullai, i datëlindjes {***}, me adresë: Rr. “{***}”, Nd. {***}, H. {***}, Ap. {***}, Njësia Administrative nr. {***}, {***}, Tiranë, me nr. tel: {***}, e-mail: {***}, përfaqësuar me prokurë të posaçme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.03.2023, nga Av. Juljan Mërtiri, me adresë: Rr. “{***}”, {***}, Ap. {***}, Tiranë dhe nr. tel: {***}.

OBJEKTI: Rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 13, datë 20.06.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

BAZA LIGJORE: Neni 6 pika 1 e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; çështja *Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës* nr. 26374/18, datë 01.12.2020; çështja *Sevdari kundër Shqipërisë* (Aplikimi nr. 40662/19) vendimi final i datës 13.12.2022; çështja *Cani kundër Shqipërisë* (Aplikimi nr. 37474/20) vendimi final i datës 4.10.2022; nenet 42, 44, 116 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 494, 495, 496, 497, 498, 498/a të Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, shqyrtoi pretendimet dhe parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili kërkoi rishikimin e vendimit të Kolegjit (JR) nr. 13, datë 20.06.2019, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari Bledar Abdullahi (në vijim “kërkuari”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Pas hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 51, datë 30.07.2018, ka vendosur: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Abdullahi, me detyrë gjyqtar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë*”.
3. Këtë vendim, kërkuari e ankoi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), i cili me vendimin (JR) nr. 13, datë 20.06.2019 vendosi: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 51, datë 30.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Bledar Abdullahi*”. Në këtë vendim, trupi gjykues i Kolegjit ka vendosur se vendimi i Komisionit nr. 51, datë 30.07.2018, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi, pasi subjekti i rivlerësimit Bledar Abdullahi gjendet në kushtet e nenit D, pikat 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
4. Në vijim, kërkuari ka paraqitur në Kolegji kërkesën me nr. {***} prot., datë 29.03.2023, me objekt rishikimin e vendimit të sipërcituar të Kolegjit, e cila është regjistruar si çështja me nr. 31-25/2018 regjistër (JR), datë 29.03.2023.

II. Pretendimet e kërkuarit

5. Në kërkesën për rishikimin e vendimit (JR) nr. 13, datë 20.06.2019 të Kolegjit, kërkuari ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se ish-gjyqtari L. D., kryesues i trupit gjykues që gjykoj çështjen e rivlerësimit kalimtar të kërkuarit (subjektit të rivlerësimit Bledar Abdullahi) në Kolegji, është dënuar për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, me vendim penal të formës së prerë¹. Në këto rrethana, duke qenë se njëri prej anëtarëve të trupit gjykues që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes së kërkuarit në Kolegji, ka kryer një veprë të dënueshme penalisht, që ka ndikuar në dhënien e vendimit në procesin e tij të rivlerësimit, kërkuari kërkoi rishikimin e vendimit të sipërcituar të Kolegjit, sipas përcaktimeve të nenit 494, shkronja “c”, të Kodit të Procedurës Civile.

¹ Kërkuari referon vendimin nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me anë të së cilit është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe me vendimin e datës 21.03.2023 të Gjykatës së Lartë.

5.1. Sipas kërkesit, përcaktimet kushtetuese, vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe nr. 78/2017, si dhe parashikimet e ligjit nr. 84/2016, e kanë konsideruar Kolegjin si një organ kushtetues dhe një gjykatë shumë të rëndësishme për shqyrtimin e ankimeve të subjekteve gjatë procesit kushtetues të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i përbërë nga gjyqtarë që gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykatat e brendshme, në mënyrë përfundimtare, kanë konstatuar faktin se nuk është respektuar ligji gjatë procedurës së aplikimit, për zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarit të Kolegjit, z. L. D. dhe se ky shtetas nuk i plotësonte kriteret ligjore të parashikuara në nenin 6, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 84/2016, për t’u emëruar gjyqtar në Kolegji.

5.2. Kërkuesi ka pretenduar se është në të drejtën e tij për t’u ankuar ndaj vendimit gjyqësor të formës së prerë (JR) nr. 13, datë 20.06.2019 të Kolegjit, nëpërmjet mjetit të ankimit të jashtëzakonshëm, që është kërkesa për rishikim, pasi parregullsitë e konstatuara në procedurën e emërimit të gjyqtarit L. D., anëtar dhe kryesues i trupit gjykues që shqyrtoi ankimin e subjektit të rivlerësimit Bledar Abdullahi dhe fakti që ky gjyqtar ka kryer një vepër penale për të ardhur në këtë detyrë, për të cilën është dënuar me burgim me vendim gjyqësor të formës së prerë, janë rrethana që vlerësohet se kanë ndikuar në dhënien e një vendimi të padrejtë ndaj kërkesit, në privim të së drejtës së tij për t’u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj. Parregullsitë në procedurën e emërimit të gjyqtarit L. D., fakti që ai ka qenë i shkarkuar më parë nga detyra e gjyqtarit për shkelje të ligjit dhe paaftësi në detyrë, si dhe fakti që ka kryer një vepër të dënueshme penalisht për të siguruar riemërimin e tij në detyrën e gjyqtarit, kompromentojnë legjitimitetin e trupit gjykues ku bënte pjesë gjyqtari kryesues L. D., gjykatën e krijuar me ligj, pavarësinë personale të këtij gjyqtari, kompetencën teknike, integritetin moral të tij dhe aftësinë për të dhënë drejtësi, duke e bërë të parregullt vetë vendimin gjyqësor të dhënë nën ndikimin e këtyre rrethanave, i cili duhet të rishikohet.

5.3. Kërkuesi ka pretenduar se kërkesa për rishikimin e vendimit (JR) nr. 13, datë 20.06.2019 të Kolegjit, është paraqitur pranë Kolegjit si gjykata kompetente, brenda afatit ligjor dhe nga kërkuesi që është personi i interesuar.

5.4. Kërkuesi duke iu referuar përcaktimeve të Kushtetutës dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese², parashtron se e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare ka një vend të posaçëm, duke i renditur ato fill pas Kushtetutës dhe duke i dhënë atyre fuqi mbi ligjin në sistemin e burimeve normative. Sipas këtij legjislacioni, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe vendimet e GjEDNj-së gëzojnë një status të privilegjuar dhe ekskluziv me efekt të drejtpërdrejtë në rendin juridik shqiptar. Në këto kushte, sipas kërkesit, Kolegji duhet të pranojë për shqyrtim kërkesën për rishikim dhe duhet të lejojë rishikimin e vendimit të sipërcituar edhe në frymën e konsideratave dhe konkluzioneve të vendimit final të GjEDNj-së, në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*, datë 13.12.2022, në të cilin gjykata ka konkluduar, ndër të tjera, se legjislacioni i rivlerësimit kalimtar njeh institutin e rishikimit dhe se me zbulimin e rrethanave të reja ose çdo baze tjetër të parashikuar në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, është legjitime bërja e një kërkesë për rishikim para autoriteteve kombëtare. Në paragrafin 46 të vendimit të sipërcituar, si dhe në paragrafin 111 të tij, gjykata është shprehur se: *Kërkuësja nuk paraqiti, pas vënies në dijeni për dyshimet në lidhje me përshtatshmërinë e L. D., për pozicionin e tij, një kërkesë për rishikim përjashtimor në vendimin e formës së prerë të KPA-së në çështjen e saj, mbështetur në faktet e*

² Vendimi nr. 6/2006, vendimi nr.9/2010, vendimi nr.20/2011 të Gjykatës Kushtetuese.

zbuluara rishtazi apo për ndonjë shkak tjetër të parashikuar në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile [...].

Kërkuesi sjell në vëmendje, gjithashtu, se më datë 04.10.2022, GjEDNj-ja ka dhënë vendimin për çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, në të cilën ka vendosur se ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me të drejtën e kërkuesit (Besnik Cani) për një “gjykatë të krijuar me ligj”. Po ashtu, kërkuesi referon se në çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, GjEDNj-ja i është referuar parimeve të vendosura nga Dhoma e Madhe në gjykimin e çështjes *Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës* dhe testit të tre fazave të përcaktuara në të.

5.5. Kërkuesi pretendon se prezenca e ish gjyqtarit L. D. në trupin gjykues që shqyrtoi çështjen e tij në Kolegj, përbën shkelje të së drejtës për një “gjykatë të krijuar me ligj” sipas nenit 6/1 të KEDNJ-së, pasi ka kryer një vepër të dënueshme penalisht dhe kjo ka ndikuar në dhënien e vendimit në procesin e tij të rivlerësimit. Për rrjedhojë, në kuadër të përcaktimeve të nenit 494, shkronja “c”, si dhe neneve 495 - 498, të Kodit të Procedurës Civile, kërkuesi kërkon rishikimin e vendimit (JR) nr. 13, datë 20.06.2019 të Kolegjit.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Procesi gjyqësor në Kolegj

a) Juridiksioni i Kolegjit

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.
Gjithashtu, sipas pikës 3 të këtij neni, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë: (a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; (b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.
7. Në vijim të sa më sipër, i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit nuk ka asnjë parashikim të shprehur për të drejtën procedurale të subjekteve të rivlerësimit për paraqitje kërkesë për rishikim, brenda kuadrit të zhvillimit të këtij procesi. Po ashtu, kuadri ligjor nuk parashikon e as rregullon ndonjë kompetencë të Kolegjit që ushtrohet përtej funksionit kontrollues të vendimeve të Komisionit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga subjektet dhe Komisioneri Publik.
8. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, trupi gjykues, pa përsëritur sa është arsyetuar gjerësisht nga Kolegji në trajtimin e kërkesave me të njëjtën natyrë e objekt³, si dhe duke ndjekur të njëjtën analizë sistematike të dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, dhe sipas orientimeve të instrumenteve

³ Shih vendimin e Kolegjit nr. 12, datë 29.04.2024, në https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendim-JR-Artor-Ylli_perfshire-mendimet-paralele_anonimizuar_word-1.pdf.

ndërkombëtare, që normojnë parimet mbi të cilat zhvillohet edhe procesi i rivlerësimit kalimtar, rikonfirmon vlerësimin që Kolegji i Posaçëm i Apelit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuesit dhe në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, shkronja “ë” të Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

9. Konkretisht, rrethanat që ligji parashikon se përbëjnë bazë për rishikimin e vendimeve, vlerësohet se nuk gjejnë zbatim në kontekstin e procesit të rivlerësimit të kërkuesit. Në kushtet që procesi i rivlerësimit është i jashtëzakonshëm, zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës, nga organe me mandat të kufizuar kohor, për shkak të objektivit dhe natyrës së tij *sui generis*, që rezultojnë edhe nga mënyra se si është rregulluar në ligj, Kolegji do të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit përkatës, sipas shkronjës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, lexuar në harmoni me pikën 8, të nenit F, të Aneksit të Kushtetutës.
10. Nga këto dy dispozita, të lexuara në harmoni me njëra-tjetrën, rezultojnë se vendimet e Kolegjit mund të ankohen vetëm në GjEDNj dhe që pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë kur GjEDNj-ja ka gjetur shkelje të Konventës dhe protokolleve të saj. Në këtë kontekst, në kushtet që për kërkuesin nuk ka një vendim nëpërmjet të cilit GjEDNj-ja konkludon një shkelje të kryer në procesin e rivlerësimit të tij, duke rikonfirmuar pa përsëritur arsyetimin e kryer nga Kolegji në jurisprudencën e tij, kërkesa për rishikim nuk bën pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe as në juridiksionin rishikues të Kolegjit, sipas pikës 8, të nenit F, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 494, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Civile.
11. Së fundmi, ndonëse shkaqet e rishikimit të paraqitura prej kërkuesit nuk i nënshtrohen juridiksionit rishikues të Kolegjit sipas arsytimit të mësipërm, sërish ato, në një vlerësim *obiter dictum*, konstatohen se edhe nëse do t'i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor, do të konsideroheshin të pabazuara në fakte dhe në ligj. Në shqyrtim të pretendimeve për cenim të “gjykatës së krijuar me ligj”, për shkak të parregullsive në emërimin e z. L. D., trupi gjyqësor sjell në vëmendje se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNj”), në çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë* ka mbajtur qëndrimin se: “144. [...] konstatimi i një shkeljeje në të drejtën për një gjykatë të krijuar me ligj në çështjen konkrete, në vetvete, mund të mos merret si shkak për të ushtruar një detyrim sipas Konventës ndaj Shtetit përgjegjës për të rihapur të gjitha çështjet e ngjashme të cilat janë bërë res judicata sipas ligjit vendës⁴”. Sipas këtij qëndrimi të GjEDNj-së, nuk mund të shqyrtohet *a priori* çdo kërkesë për rishikimin e vendimeve të dhëna nga trupat gjyqësore të Kolegjit ku ka qenë anëtar ish-gjyqtari L. D., vetëm për shkak të parregullsive në emërimin e tij, dhe u takon autoriteteve kombëtare që në secilën çështje “të përcaktojnë nëse ka një nevojë të domosdoshme – të një karakteri të rëndësishëm dhe detyrues – që justifikon shmangien” nga parimet e sigurisë ligjore dhe të besimit në publik në gjyqësor “në rrethanat e veçanta të një çështje”⁵.

⁴ Shih Guðmundur Andri Ástráðsson.

⁵ Referuar paragrafit 88 të vendimit: “Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata theksoi se parimi i shtetit të së drejtës përfshin një numër parimesh të tjera po aq të rëndësishme dhe mundësisht kundërbalacuese. Këto parime përfshijnë veçanërisht sigurinë ligjore dhe respektin për forcën e res judicata, si edhe parimin e palëvizshmërisë së gjyqtarëve gjatë mandatit të tyre; shmangia nga këto parime mund të justifikohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe të

12. Sa i përket pretendimit të kërkuesit lidhur me veprën penale të kryer nga z. L. D., konstatohet se edhe nëse do t'i nënshtrohej shqyrtimit gjyqësor, do të konsiderohej si i pabazuar në fakte dhe në ligj, pasi mungon lidhja shkakësore mes vendimmarrjes së gjyqtarit L. D. në çështjen e rivlerësimit të kërkuesit dhe veprës penale për të cilën ai është deklaruar fajtor. Parashikimet ligjore që lidhen me rishikimin në asnjë rast nuk u referohen ndodhive, fakteve apo rrethanave, të cilat nuk rrjedhin apo paraprijnë ose janë shkak për marrjen e vendimit për të cilin kërkohet rishikimi. Nga ky lexim rezulton se, në mënyrë që vepra penale për të cilën anëtari i trupit gjykues është gjetur fajtor të ketë ndikuar në dhënien e vendimit, pala kërkuese duhet të provojë lidhjen shkakësore mes veprës penale dhe vendimit të kundërshtuar nëpërmjet rishikimit, ose që në momentin kur gjyqtari ka marrë vendimin, vullneti i tij është vesuar për shkak të një vepre penale, e cila ka ndikuar në vendimmarrjen objekt rishikimi. Të tilla raste do të ishin sjelljet e një gjyqtari në shkelje të parimeve të paanësisë dhe objektivitetit, provuar nga një vendim penal i formës së prerë. Një analizë e kryer duke aplikuar këto parime, është në linjë edhe me jurisprudencën e GjEDNj-së, shtjelluar në drejtim të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë që diktojnë parimet e nenit 6/1 të Konventës, si në çështjen *Brumarescu kundër Rumanisë*, ku është elaboruar që cenimi i një vendimi përfundimtar mund të legjitimohej vetëm për të korrigjuar një “dështim të drejtësisë”⁶.
13. Fakti që në rastin konkret, vepra e dënueshme penalisht është kryer nga z. L. D. para marrjes së detyrës si gjyqtar i Kolegjit dhe disa vite para dhënies së vendimit të Kolegjit që kërkohet të rishikohet, e shkëput këtë lidhje logjike dhe ligjore që kanë dy rrethanat e mësipërme, duke mos plotësuar njëkohësisht qenien gjyqtar dhe kryerjen e veprës të dënueshme penalisht. Rëndësi në vlerësimin e kushteve për rishikimin e një vendimi ka dhe fakti se sipas dispozitës vepra e dënueshme penalisht, jo vetëm duhet të jetë kryer gjatë periudhës që gjyqtari ka qenë në detyrë, por duhet të provohet dhe që ajo ka lidhje dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në vendimin që kërkohet të rishikohet. Vepra penale për të cilën është dënuar ish-gjyqtari, “Falsifikim i dokumenteve”, për nga lloji i saj nuk rezulton të ketë lidhje dhe të duket se mund të ketë ndikuar në vendimin për kërkuesin në kuadër të procesit të rivlerësimit. Për sa kohë që kërkuesi nuk sjell asnjë argument dhe provë konkrete se kryerja e veprës penale ka qenë e lidhur drejtpërdrejt me prekjen e interesave të tij, nuk shpjegohet se si kjo vepër penale mund të ketë ndikuar dhe të ketë qenë shkak determinant, në vendimin e dhënë ndaj tij. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se nuk gjen zbatim neni 494, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Civile, sikurse është elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit edhe në çështje të tjera⁷.
14. Për sa më lart, trupi gjykues arriti në përfundimin se kërkesa për rishikim e paraqitur prej kërkuesit Bledar Abdullahi, nuk bën pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, dhe as në juridiksionin rishikues të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit

mirëpërcaktuara. U takon autoriteteve kombëtare që në secilën çështje “të përcaktojnë nëse ka një nevojë të domosdoshme – të një karakteri të rëndësishëm dhe detyrues – që justifikon shmangien” nga parimet e sigurisë ligjore dhe të besimit në publik në gjyqësor “në rrethanat e veçanta të një çështjeje”.

⁶ Shih “*Brumarescu kundër Rumanisë*”, “*Pravednaya kundër Rusisë*” prg. 25, “*Bratyakin kundër Rusisë*”, ndër të tjera.

⁷ Shih për referencë vendimin që i përket kërkesës së znj. R. G.:

https://kpa.al/wpcontent/uploads/2024/11/Vendimi_Rovena_Gashi_perfshire_mendimin_paralel_anonimizuar.docx-1.pdf, si dhe vendimin që i përket kërkesës së znj. A. G.:

https://kpa.al/wpcontent/uploads/2024/11/Vendimi_Ana_Golloshi_perfshire_mendimin_paralel_anonimizuar-1-rishikim.pdf.

të Kushtetutës dhe nenit 494, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Civile, për pasojë, ajo konsiderohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji, bazuar në nenet 494 dhe 498 pika 1 të Kodit të Procedurës Civile, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Mospranimin e kërkesës së kërkuarit Bledar Abdullahi, për rishikimin e vendimit (JR) nr. 13, datë 20.06.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 24.03.2026.

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi - kundër

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, jam dakord me zgjidhjen e çështjes për vendimin nr.59 datë 24.03.2026, për çështjen nr. 31-25/2018 regjistër (JR) datë 29.03.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës së kërkuarit Bledar Abdullahi, për rishikimin e vendimit nr. 13 (JR), datë 20.06.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por kam mendim paralel, lidhur me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues, për sa parashtruar në vijim.
2. Trupi gjykues në përfundim ka konkluduar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuarit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislati i brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
3. Në ndryshim nga shumica, në analizë harmonike të dispozitave kushtetuese, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji “nr. 84/2016”) dhe legjislati në fuqi, kam vlerësuar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion rishikues për të shqyrtuar kërkesat për rishikim bazuar në të gjitha rrethanat e parashikuara të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Ky qëndrim bazohet në argumentet e referuara prej meje në mendimin paralel për kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuari A. Y.¹.
4. Sa i përket shkaqeve të rishikimit të paraqitura në kërkesën e z. Bledar Abdullahi, kam ndarë të njëjtin qëndrim si edhe pjesa tjetër e trupit gjykues, të pasqyruar në paragrafët 11-13 të vendimit, duke i konsideruar ato të pabazuara mbi të njëjtat argumente, duke vendosur mospranimin e tyre.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

¹ Shiko mendimin paralel në vendimin nr.12, datë 19.04.2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendim-JR-Artor-Ylli_perfshire-mendimet-paralele_anonimizuar_word-1.pdf

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e anëtares, jam kundër shumicës së trupit gjykues në vendimin nr. 59, datë 24.03.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit Bledar Abdullahi, për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 13 (JR), datë 20.06.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe kam ndarë mendim ndryshe sa i përket qëndrimit të mbajtur lidhur me arsyetimin për mungesën e juridiksionit rishikues¹ të Kolegjit, për shqyrtimin e kërkesave që nuk kanë një vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim GJEDNJ), sipas shkronjës “ë”, të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.
2. Në vlerësimin tim, Kolegji ka juridiksion rishikues për shqyrtimin e kërkesave për rishikim vendimi që janë paraqitur bazuar në nenin 494², shkronja “c”³ të Kodit të Procedurës Civile dhe argumentet e mia kundërshtuese për mungesën e juridiksionit rishikues, janë shprehur në mënyrë shteruese dhe konsistente ndër të tjera në mendimin e pakicës ndaj kërkesës së kërkuarit R. T.⁴ si dhe mendimet paralele dhe qëndrimin e mbajtur prej meje në kërkesat për rishikim të paraqitura në çështje të tjera⁵.
3. Një interpretim nga Kolegji që pranon rishikimin vetëm pas vendimit të GjEDNJ-së, në përgjigje të ankimit të kërkuarit (subjekt rivlerësimi), e bën juridiksionin rishikues të varur vetëm nga gjykata e Strasburgut, duke hequr mundësinë e çdo mekanizmi korrigjues të brendshëm dhe duke krijuar një vakum juridik për shkelje serioze që nuk kanë arritur ende në GjEDNJ.
4. Pranimi i juridiksionit rishikues vetëm në mënyrë minimaliste dhe vetëm për vendimet e GjEDNJ-së, në vlerësimin që i bëj çështjes, duket se krijon një kontradiktë logjike, sepse e bën rishikimin një “mjet të jashtëm” dhe jo “mjet të brendshëm”, duke lënë pa zgjidhje gabimet serioze të brendshme që përbëjnë shkaqet e rishikimit sipas shkronjave të tjera të nenit 494 të Kodit. Pra, nëse rishikimi do të ekzistojë vetëm pasi GjEDNJ-ja të shprehet me një vendim të posaçëm për kërkuarin (subjekt rivlerësimi), kjo do të passillte që mjeti i brendshëm të mos jetë efektiv⁶ dhe kjo mund të çojë në shkelje të nenit 13⁷ të KEDNJ-së.

¹ Ky qëndrim është mbajtur nga shumica e trupit gjykues në vendimin nr. 12, datë 19.04.2024, që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuarit A. Y., regjistruar me nr. 2-4/2019 regjistër (JR), datë 10.1.2022, me objekt “Rishikimi i vendimit të formës së prerë nr. 31 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, në të cilin nuk kam qenë anëtare e trupit gjykues.

² Neni 494 i KPrC: “Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur: [...] (c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit; [...] (ë) kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

³ Në vendimin e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023, që i përket kërkuarës R. G., me mendim paralel, jam shprehur që kërkesa e katërt, për rishikimin e vendimit nr. 12/2019 të Kolegjit, sipas shkronjës “c” të nenit 494, është e bazuar dhe përbën shkak për rishikimin e vendimit përfundimtar.

⁴ Vendimi nr. 19, datë 08.05.2025, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit R. T., për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 26 (JR), datë 21.10.2019.

⁵ Vendimi nr. 9, datë 28.2.2025, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit A. B. për rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 11 (JR), datë 03.07.2020; Vendimi nr. 18, datë 8.5.2025, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket shqyrtimit të kërkesave të kërkuarit A. Gj. për rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 9 (JR), datë 26.6.2020, etj.

⁶ Çështja “Scordino v. Italy (No. 1) (GC, 2006) (Application no. 36813/97) - <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-72925>”.

⁷ Neni 13 i KEDNJ-së: “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

5. Në përfundim, lidhur me kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Bledar Abdullahi më datë 29.03.2023 për rishikim të vendimit nr. 13/2019 (JR), në ndryshim nga shumica e trupit gjykues dhe në linjë me qëndrimin e mbajtur në mendimin paralel të vendimit nr. 34/2023, që i përket kërkesës për rishikim të kërkueses R. G., shprehem se Kolegji ka juridiksion për rishikimin e kërkesës dhe kjo e fundit është e bazuar në nenin 494/c, duke përbërë shkak për rishikim, për arsytet si vijon:

5.1. Kërkesa e kërkuetit Bledar Abdullahi plotëson kërkesat e nenit 494, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Civile dhe, në këtë rast, nuk jemi para asnjë prej parashikimeve të nenit 498 të këtij Kodi.

5.2. Legjitimimi i kërkuetit në rastin konkret, duke paraqitur kërkesën për rishikim në momentin e marrjes formë të prerë të dënimit penal ndaj gjyqtarit të trupit gjykues të çështjes së tij, si dhe pasi Gjykata e Lartë la sërish në fuqi vendimin e Apelit⁸, edhe pas prishjes pjesërisht të vendimit nga Gjykata Kushtetuese⁹, vjen në përputhje me përcaktimet e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.

5.3. Në një interpretim të nenit 494/c të Kodit të Procedurës Civile, lexuar literalisht, pa i shtuar kuptime të tjera të tërthorta, të cilat shkronja “c” nuk i ka të shprehura, vlerësoj se duhet të lejohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë, kur një anëtar i trupit gjykues ka kryer vepra të dënueshme penalisht, që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, një trup gjykues, i cili nuk është formuar “sipas ligjit”, cenon thelbin e procesit të drejtë¹⁰. Sa i përket ndikimit që ka dënimi penal i anëtarit të trupit gjykues në dhënien e vendimit që i përket kërkuetit, vlerësoj se në çdo rast, pjesëmarrja në trupin gjykues e një anëtari që ka kryer një veprë të dënueshme penalisht, ndikon në dhënien e vendimeve të kësaj trupe gjyqësore, për shkak të vesimit nga kryerja e veprës penale.

5.4. Për sa më lart, shkronja “c”, e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile duhet të zbatohet nga Kolegji literalisht, ashtu si është shkruar, çka nënkupton se kjo dispozitë nuk ka parashikuar raste përjashtimore për kohën e kryerjes së veprës penale nga anëtari i trupit gjykues. Pra, neni 494 i Kodit të Procedurës Civile parashikon rregullime shumë të detajuara dhe në mënyrë shteruese për rastet e kërkesave për rishikim. Ligjëbërësi, duke i kushtuar një rëndësi e kujdes të posaçëm rregullimit në Kod të institutit të rishikimit të vendimit (si në rastin e shkronjës “c”), nuk mund të linte pa rregullim të specifikuar ndonjë përjashtim nga parashikimi i përgjithshëm i shkronjës “c”, të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke mos e lënë të nënkuptohet nga zbatuesit e këtij Kodi as kohën e kryerjes së veprës penale nga anëtari i trupit gjykues dhe as ekzistencën apo jo të lidhjes shkakësore për ndikim në dhënien e vendimit nga trupa gjyqësore.

5.5. Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së dhe lexuar në harmoni me përmbajtjen e nenit 494/c të Kodit të Procedurës Civile, ekziston një detyrim që vendimet e marra nga një trup gjykues që nuk plotëson kërkesat e një gjykate “të krijuar me ligj”, duhet të rishikohen, për të siguruar që çdo padrejtësi e mundshme të korrigjohet. Ky pohim përbën një masë të nevojshme dhe merr një peshë veçanërisht të rëndësishme në kontekstin e reformës në drejtësi në Shqipëri, ku integriteti i procesit të *vetting*-ut, si një proces i jashtëzakonshëm e kalimtar, është thelbësor për rikthimin e besimit të

⁸ Vendimi nr. {***}, datë 08.03.2021, i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar la në fuqi vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar “Për deklarimin fajtor të të pandehurit L. D. për kryerjen e veprës penale të ‘falsifikimit të dokumenteve’, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim.”

⁹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 21, datë 26.09.2022.

¹⁰ Në rastin *Dudek v. Germany* (2018), gjykata vendosi që një shkelle e tillë kërkon domosdoshmërisht rishikim, pavarësisht nga ndikimi real i gjyqtarit të dënuar në vendimin përfundimtar. Kjo është për shkak të rrezikut që perceptimi i një padrejtësie në formimin e trupit gjykues, mund të ketë ndikim në besimin e publikut në drejtësi: <https://hudoc.echr.coe.int/tur#%7B%22itemid%22:w%22001102218%22%7D;~:text=https%3A/hudoc.echr.coe.int/tur%3Fi%3D001%2D102218>

publikut në sistemin gjyqësor. Në këtë linjë arsyetimi, edhe integriteti i trupit gjykues është thelbësor për besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Çdo shkelje e këtij integriteti si, dënimi penal i një gjyqtari, duhet trajtuar me seriozitet për të ruajtur besueshmërinë e procesit gjyqësor.

5.6. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, si organi kushtetues më i lartë dhe e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit kalimtar, si institucioni i pavarur që Kushtetuta¹¹ i ka dhënë atributet e Gjykatës Kushtetuese¹² dhe i ka përcaktuar një mision të qartë, si dhe që vendimmarrjet e tij t'i bazojë në parimet e procesit të rregullt, duke respektuar të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit, sipas parashikimeve të Konventës, Kushtetutës, ligjit të posaçëm¹³ dhe ligjeve të aplikueshme, duhet të demonstrojë dhe të transmetojë siguri juridike dhe qartësi për ato aspekte të gjykimit që dhënia e drejtësisë i sjell për të zbatuar, sikurse është edhe mjeti i jashtëzakonshëm i rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

5.7. Dënimi penal i një anëtari të trupit gjykues, për arsye që nuk lidhen me vendimmarrjen e tij, por me kushtet për të qenë anëtar i këtij Kolegji, cenon standardin e integritetit gjyqësor dhe besueshmërinë e trupit gjykues dhe, për rrjedhojë, pozitën vendimmarrëse të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paanshmërinë e tij, si dhe standardin e gjykatës së krijuar me ligj, të parashikuar dhe nga neni 6 i KEDNj-së. Në fund të fundit, vendimi penal i formës së prerë ndaj një anëtari të trupit gjykues që ka shqyrtuar ankimin e kërkuarit (në cilësinë e subjektit të rivlerësimit), ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit¹⁴, është një fakt i pakundërshtueshëm, i cili në një formë apo në një tjetër implikon sjelljen institucionale të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, integriteti institucional i të cilit duhet të mbrohet nëpërmjet zbatimit të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, që e kanë sanksionuar atë.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

¹¹ Neni 179/b, pika 1 e Kushtetutës parashikon se: “Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”.

¹² Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës parashikon se: “[...] Gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare, Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje”.

¹³ Neni 1 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës”.

¹⁴ Vendimi nr. 51, datë 30.07.2018, i KPK-së për subjektin e rivlerësimit Bledar Abdullahi.